Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 64/17
Datë/Datum 30.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit Ministria e Administratës Publike	Kopja:	Panelit shqyrtues OSHP
Prej:	Qazim Hoxha Ekspert shqyrtues/teknik i prokurimit		
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Cargomax Prishtina" me seli në Komoran, me numër protokollit 64/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPB-s" Pjesa nr. 1- "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetit kamion special zjarrëfikës - Iveco ", me nr. të prokurimit 214-16-147-211, kundër autoritetit kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme,		
Data:	**30.03.2017**		

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës së prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPB-s" Pjesa nr. 1- "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetit kamion special zjarrëfikës - Iveco ", me nr. të prokurimit 214-16-147-211, kundër autoritetit kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme si dhe me Përgjegjjen ndaj ankesës nr. 64/17 të dorëzuar më 30.03.2017.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-s.

Bashkangjitur:

Raporti i ekspertit shqyrtues

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES / TEKNIK

Qazim Hoxha		22.03.2017		23.03.2017		30.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

Neni 105 i LPP Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-037, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 - Baza ligjore e shqyrtimit

Më 06.03 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE "Cargomax Prishtina" me seli në Komoran, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPB-s" Pjesa nr. 1- "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetit kamion special zjarrëfikës -Iveco ", me nr. të prokurimit 214-16-147-211, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) .
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-s, Eksperti Shqyrtues i OSHP-s e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

Neni 109,- Operatori Ekonomik ankues: "Cargomax Prishtina" , Komoran

Pikat e ankesës:

- Shkelje e nenit 1 të LPP-së, Qëllimi i LPP-së;
- Shkelje e nenit 56 të LPP-së , Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminim, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 61- Tenderët jonormalisht të ulët;
- Shkelje e nenit 62 të LPP-së nr. 05/L-068, Përfundimi i aktivitetit të prokurimit;

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ankesa bazohet ne bazen ligjore, arsyeshmerine, faktet, argumentet dhe deshmite si ne vijim:

- Pala pretendon se është shkel Neni 1 i LPP - Qëllimi

Pretendojmë se vendimi i Komisionit Vlerësues (KV) për ta eliminuar kompaninë tonë eshte ne kundershtim me nenin 1,paragrafin 1 te LPP-se. Qëllimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren

me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke percaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen.
Sipas këtij neni zyrtarët e prokurimit gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë të obliguar të përkujdesen për qëllimin e këtij ligji. Pra, pretendojmë se AK nuk e ka zbatuar qëllimin e këtij ligji.
Pretendojmë se është shkel neni 56 i LPP-së, paragrafet 1.1 dhe 1.2, ku KV ka dështuar të vlerësoj sipas kritereve të kualifikimit dhe përgjegjshmërisë administrative, të publikuara me Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

- **Pala pretendon se është shkel neni 59 i LPP- Ekzaminimi krahasimi dhe vleresimi i tendereve.**

Pretendohet se Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 59 i LPP-se sepse ekzaminimi dhe vleresimi i tendereve nuk eshte bere sipas kerkesave te dosjes se tenderit. Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, nuk do të diskualifikohet ose perjashtohen nga procedurat e tilla ne baza te ndonje kerkese ose kriteri qe nuk eshte i cekur ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

Me kete veprime, sipas OE ankues, Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 , paragrafin 2 e 4, te LPP-se Nr.04/L-042. Ne letren standarde per tenderuesin eliminuar AK arsyeton se ne si dëshmi i kemi dorëzuar kontratat e papërfunduara, kërkesë kjo që nuk është paraparë në FDT. Në këtë dokument (FDT),paragrafi 9.1. pika b, tekstualisht parashihet: "**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku 2 kontrata per servisimin e automjeteve,të realizuara në 3 vitet e shkuara 2013,2014, 2015.**" (Provë: Dosja e Tenderit).

Në vijim,pala në ankesë e risjell përmbajtjen e njoftimit për eliminim, ku e konteston arsyetimin dhe vlerësimet se referencat dhe kontratat janë me mungesa të caktuara karrshikërkesës së tyre. Pra, kontesti themelor ka të bëjë me interpretimet e nocionit "i realizuar", përkatësisht kontrata të pa përfunduara, memospranimin e atributeve të referencave të marra nga KEDS e edhe me cështjet e panimit të shërbimeve brenda periudhës së cituar, ku pala dëshmon se keto sherbime janë realizuar(pranuar) brenda periudhes se kerkuar 2014, 2015 , sepse fillimi i kontrates ka qenë më 11.07.2014. Pra, edhe pse nuk i mbulon tri vite, kontrata i përket kësaj periudhe 3 vjecare.
(Detajet në Ankesë/Trajtimi më i detajuar do t'i bëhet tek Konstatimet, më poshtë).

- **Pala pretendon se eshte shkelur nenin 61 i Ligjit i cili ka të bëjë me kualifikimin e tenderit për çmime jonormalisht të ulëta ,-** ku i kundërshton argumentet se ka ofruar çmime joobjektive.
Argumentimin e AK se në shumë pozicione të ndryshme ka ofruar çmime të njëjta, pala e kundërshton me argumentin se LPP askund nuk e parasheh eliminimin pse në ofertë jepen cmime të njëjta,për pozicione të ndryshme. Në fakt, pala argumenton se kriteri themelor është cmimi më i ulët,e në rast se mendohet se këto cmime janë jonormalisht të ulëta atëherë AK ka pas bazë tjetër për trajtim të tyre konform nenit 61 dhe Rregullave të KRPP.
Mëtej, krahas kësaj pala me ankesë ofron edhe bazën ligjore të trajtimit të cështjes – Rregullat për

tenderët jonormalisht të ulët, përkatësisht dispozitat e nenit 4 të këtyre rregullave..

- Pala pretendon se eshte shkelur nenin 62 i Ligjit - ku përshkruhen dispozitat per perfundimin e e aktiviteti te prokurimit, sepse sipas tyre arsyetimi i eliminimit në Njoftim nuk është i argumentuar.

- Përfundimisht pala kerkon nga OSHP qe te anulohet Njoftimi per Anulim te ketij Aktiviteti te Prokurimit dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Po sqarojmë se të gjitha pretendimet e lartpërmenduara ankimore do t'i shqyrtojmë më përafër në vijim të trajtimit të lëndës tek *Konstatimet.*

Dëshmitë e bashkangjitura me ankesën:

1. Njoftimi për kontratë
2. Njoftimi për anulim të tenderit
3. Procesverbali i hapjes së ofertave
4. Korrespondenca me AK-n
5. Letra standarde për tendruesin e eliminuar
6. Kopja e depozitit të paguar për ankesë

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues:	02.02.2016
Data e njoftimit për kontratë:	21.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë kornizë për shërbime-ritender / vlerë e madhe
Vlera e përllogaritur për këtë prokurim:	171 000.00 euro
Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK:	10.10.2016/ 171 000.00 euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, (gjithsej ditë):	23.01.2017 / 30 dite
Data e hapjes së ofertave:	23.01.2017
Data e njoftimit për anulim të tenderit:	20.02.2017

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (Neni 60):
Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët/ sipas peshimit në përqindje

III.1.1 - Kushtet për pjesëmarrje/kërkesat e përshtatmërisë:

1. Deklaratën nën betim,origjinal
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit se nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit,kopje - për fituesin.
3. Vërtetimi i lëshuar nga gjykata kompetente për mosudhëheqje të hetimeve ,origjinalose kopje e noterizuar -vetëm për fituesin

III.1.2 – Përshtatmëria profesionale:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit, kopje;
2. Certifikata e nr. fiskal, kopje;
3. Certifikata e TVSH-s, kopje;

III.1.3 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

III.1.4- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (sipas nenit 69 të Ligjit Nr. 04/L-042):

1. Servis(objekt) me hapsirë minimum 200m2, me të gjitha kushtet. Distanca më së largut 15 km nga Rr. L.Haradinaj,Prishtinë, për distanca më të mëdha OE fitues obligohet të ketë transport për bartje të këtyre mjeteve për servisimderinë objektin e vet./ kërkohen dëshmi: dokumentacioni zyrtar mbi pronësinë ose qiramarrjen;
2. Vinc hidraulik për ngritje të automjeteve-minimum 3 vinca/dëshmi: fotot ose dëshmitjera;
3. Pajisje për vullkanizimtë gomave-minimum 1/dëshmi: fotot ose dëshmitjera;
4. Pajisje speciale kompjuterike për detektimin e defekteve të automjeteve –min.1/ dëshmi: fotot ose dëshmi tjera;
5. Pajisje për mbushjen e klimave-minimum 1/ dëshmi: fotot ose dëshmi tjera;
6. Automjet për bartje/tërheqje të automjeteve në rast defekti në rrugë/ të dëshmohet me fotografi ose certifikata(libreza),në pronësi ose me qira;
7. Automjet transportues të automjeteve të rënda -minimum 1 për Lot 1e 2/ të dëshmohet me fotografi ose certifikata(libreza),në pronësi ose me qira;
8. Automjet transportues për tërheqje të automjeteve të vogla-minimum 1 për Lot 3/ të dëshmohet me fotografi ose certifikata(libreza),në pronësi ose me qira;
9. Pajisje për reglazhë të automjeteve-minimum 1/ dëshmi: fotot ose dëshmi tjera;
10. Të ketë Autorizim të prodhuesit ose distributorit për pjesë rezervë për kamion të

Ivecos(për Lot 1),origjinalose të noterizuar; Përvoja e kompanisë të dëshmohet me minimum 2 kontrata për 3 vitet e shkuara 2013-2015 / kërkohen dëshmi: lista e kontratave me që specifikon shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin,duke i bashkangjitur dëshmi kopjen e certifikatave të pranimit ose referencat, të nënshkruara nga pranuesi për kontratat e cekura në listë(kopje);

11. Automekanikë-minimum 2/dëshmi: diplomat ose certifikatat;
12. Autoelektricist-minimum 1/dëshmi: diploma ose certifikata dhe kontrata valide e punës;
13. Personeltjetër ndihmës për vulkanizimj të gomave dhe shërbime tjera-minimum 1/dëshmi: dhe kontrata valide e punës;

III.2.1 - Kërkesat për sigurim të tenderit

Vlera e sigurisë: 2000 euro për Lot1/përkatësisht 4000 euro totali per 3 lot-et;
Vlefshmëria: 120 ditë

III.2.2 - Periudha e vlefshmërisë së tenderit

90 ditë

III.3.1 - Sigurimi i ekzekutimit

Vlera e sigurisë: 10 % e vlerës së kontratës, përkatësisht e secilit Lot ;
Vlefshmëria: 37 muaj

Regjistri i operatorëve ekonomikë sipas procesverbalit të hapjes publike (vetëm Lot1) :

Nr	Operatori ekonomik	Selia e OE-s	Pjesa 1 Çmimi i ofertës/euro
1	CARGOMAKS PRISHTINA SHPK	Komoran	66 447.46
2	KOMBINIMI SHPK	Prishtinë	100 541.29

Sipas nënshkrimeve të procesverbalit të hapjes së tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave për Lot 1 ka marrë pjesë 1 përfaqësues i OE , nga 2 sa kanë konkurruar në tender.
Procesverbali i hapjes së tenderëve është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes së ofertave dhe përfaqësuesit pjesëmarrës të OE-ve pa ndonjë vërejtje. I njëjti është nënshkruar edhe nga *Zyrtari i Prokurimit.*

Komisioni për vlerësim të ofertave i AK-s

Përbërja e komisionit vlerësues (Neni 59) Autoriteti kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin e vlerësimit me *Vendimin e datës 24.01.2017.* Komision ka qenë në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve si në vijim: 1. Blerim Isa, kryesues 2. Safet Dizdari, anëtar 3. Fatmir Thaqi, anëtar

Data e fillimit të vlerësimit:	26.01.2017
Data e mbarimit të vlerësimit:	10.02.2017
Data e njoftimit për anulim të tenderit:	20.02.2017

Raporti i vlerësimit

Bazuar në kriteret e kërkuara në Dosje si dhe procesverbalet e kontrollimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit komisioni vlerësues ka nxjerrë raportin në vijim:

- Vërejmë se Raporti është përpiluar e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe Zyrtarit të Prokurimit.

- Mbështetur në Raportin e Vlerësimit vërejmë se të 2 ofertat e pranuara për Pjesën 1 i kanë përmbush kriteret e përshtatshmërisë administrative dhe profesionale.

- Mëtej vërejmë se Komisioni i Vlerësimit, pas një analize detale të kritereve mbi mundësitë profesionale dhe teknike, nxjerr përfundimet se asnjëra nga ofertat nuk janë të përgjegjshme në aspektin e afftësive teknike e profesionale. Në fakt, me raport jepen detajet e mospërmbushjes së kritereve për aftësitë profesionale e teknike për secilën nga ofertat e pranuara.

- Përfundimisht, konform ekzaminimeve në raport, Komisioni rekomandon anulimin e tenderit për mungesë ofertash të përgjegjshme, të cilin e pranon dhe konfirmon me nënshkrimin e tij edhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (Neni 113, 114)

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Konstatimi 1

Nga ekzaminimi i shkresave, gjetjet tona tregojnë se kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale të AK në Dosje të Tenderit kanë qenë të qarta. Është kërkuar që të sillet lista e kontratave, minimum 2, të realizuara brenda periudhës së kaluar 2013-2015. Poashtu, në Dosje të Tenderit, më saktë në FDT pikat 9.1. i dhe 9.4 i, specifikohet qartë se kontratat duhet të tregojnë: **shërbimet e përfshira, datën dhe pranuesin, duke ia bashkangjitur dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë.**

S'do mend se kontratat e nënshkruara, nuk nënkuptojnë automatikisht zbatimin dhe se artikulimi i kërkesave konkrete që tregojnë aftësinë e pjesëmarrësve për t'i përmbush kontratat në kohëzgjatjen e parashikuar është një kërkesë e mbështetur në ligj.

Dilemat që pala në ankesë i ngrit lidhur me interpretimin e kohëzgjatjes në performim që mbulojnë këto kontrata si dhe dëshmive që ka ofruar lidhur me shërbimet e realizuara (pranuara), vlerësojmë se janë të pa argumentuara. Sipas nenit 69 pika 1.1 të LPP , kriteri dhe kërkesat janë të formuluara në pajtim me këtë dispozitë, e cila përcakton se AK mund të kërkojë:

"listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin;"

Pra, sipas këtij neni saktësohet periudha e shkuar trevjecare, poashtu edhe pranimi i shërbimeve me të gjitha detajet e pranimit. Nëse i referohemi dates se saktë të fillimit të zbatimit të kontratës me KOSST-in (29.12.2014), del se kjo periudhë është 1 vit, kurse për kontratën me KEDS-in rreth një vit e gjysmë (11.07.2014), ose më pak se gjysma e periudhës së parashikuar të zbatimit të kontratës.

Për më tepër, edhe përpjekja për t'u arsyetuar me përqindjen e realizimit të kontratës kornizë me KOSST-in duket se dështon, ngase as ky element nuk arrin në 70 % si limit i pranueshëm i realizimit të kontratës kornizë(nuk është dëshmuar ky fakt as në referencë, ku veç vlerës totale të kontratës, nuk jepet fare vlera e deritashme e pranimit të shërbimeve - *Provë: Referenca nga KOSST*).

Ndërkaq, trajtimi i kontratës me KEDS-in si kontratë publike kornizë sipas kuptimit që i jepet

në LPP është i pa pranueshëm, ngase nuk është as në formë e as në përmbajtje të kontratës publike kornizë që u nënshtrohet rregullave të LPP në Kosovë. Kjo është një kontratë kornizë biznesi mes 2 kompanive private(njëra nga të cilat është ofrues i shërbimeve publike) me elemente të kontratave standarde, e cila nuk i përmban kushtet specifike që kërkohen nga kontratat kornizë sipas nenit 38 të LPP, në të cilin thirret ankuesi.

Pa u thelluar mëtej, duket qartë se kërkesat në formën që janë artikuluar në FDT nuk janë përmbush në tërësinë e vet.

Prandaj, në përputhje me analizën e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i pabazuar.

Konstatimi 2

Mëtej, në përgjegje të pretendimit se AK ka anashkaluar procedurat e vlerësimit edhe me faktin se anulimin e justifikon edhe me parregullsitë e çmimeve të ofruara, vlerësojmë se kjo çështje kërkon trajtim tjetër.
Në fakt, **këtu nuk kemi të bëjmë fare me çështjen e çmimeve jo normalisht të ulëta**, sepse AK as që ka inicuar një procedurë të tillë dhe se thirrja në këto dispozita në ankesë është krejtësisht e pa bazuar. Duket se shkas për ngritjen e këtij pretendimi ka qenë pjesa e dytë e arsyetimit të shkresës për eliminim drejtur palës në ankesë, ku AK i cilëson si të parregullta çmimet e njëjta të përsëritura për qindra pozicione të ndryshme (416 herë përsëritet vetëm çmimi prej 41.30 euro).
Edhe pse është evidente se kjo sjellje e operatorit në këtë pikë është e pakuptueshme, vlerësojmë se legjislacioni aktual nuk e parasheh mundësinë e veprimeve konkrete për parandalim të këtyre veprimeve nga ana e vetë Autoritetit Kontraktues.
Në rastin më të mirë, AK këto çmime ka mund t'i cilësojë si çmime jo të pranueshme, por nuk ka mekanizëm tjetër parandalimi të këtyre anomalive. Megjithatë, konform kompetencave që i përshkruhen, vetëm OSHP mund t'i kualifikojë si " sjellje të gabuara" konform nenit 132, paragtrafi 2.3 ku përcaktohet se OSHP " *nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e operatorit ekonomik gjatë aktivitetit të prokurimit...*" mund të veprojë për parandalimin e prokurimeve të mbyllura në kundërshtim me këtë ligj. Rrjedhimisht, OSHP këtë veprim do të mund ta trajtonte mëtej përmes **Deklarates së Joefektivitetit**, sipas nenit 133 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 të amandamentuar.

Në këtë kontekst, vlerësojmë se arsyeja shtesë për eliminim nuk e zbeh aspak argumentin kryesor për mospërmbushje të kriterit pë aftësitë teknike e profesionale (të trajtuar më sipër në Konstatimin 1), për ta arsyetur vendimin e vet për eliminim, përkatësisht anulim të tenderit.

Prandaj, konform shqyrtimit të mësipërm, konstatojmë se pretendimi i ankuesit edhe në këtë pikë nuk është i bazuar .

Konstatimi 3

Përfundimisht , për sa u tha më lartë, vlerësojmë se argumentet që sollëm flasin mjaftueshëm për rrëzimin e pretendimeve të palës në ankesë. Megjithatë, po sqarojmë se pikat 1 e 4 që shfaqin pretendimet e palës lidhur me shkeljen e qëllimit dhe të procedurave të vlerësimit , pas shqyrtimit dhe konstatimeve të sjella më sipër në lëndë, konsiderojmë se trajtim i mëtejmë i pretendimeve tjera është i panevojshëm.

Shkeljet e konstatuara të LPP-s

Konstatojme se procedura e prokurimit është udhehequr me kompetencë nga ana e AK-s, duke respektuar hapat e paraparë ligjor dhe aspektet tjera formale-juridike në pajtim me dispozitat e LPP.

Përgjigjet në pikat e ankesës

Përfundimisht, lidhur me të gjitha pikat e ankesës, tashmë dhamë përgjigjet detaje më lartë, prandaj nuk po i përsërisim më tej.

Mendimi i eksperteve shqyrtues

Ekspertet shqyrtues teknik, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit si dhe rrjedhën e vlerësimit nga ana e AK-s, rekomandon që ankesa e OE "Cargomax Prishtina" me seli në Komoran, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPB-s" Pjesa nr. 1- "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetit kamion special zjarrëfikës - Iveco ", me nr. të prokurimit 214-16-147-211, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të,

REFUZOHET

Njëkohësisht, i rekomandojmë Panelit Shqyrtues që të aprovohet vendimi i AK-s për anulimin e tenderit, gjegjësisht t'i lejohet AK-s që të vazhdojë me procedurat e mëtejme të ritenderimit, nëse edhe mëtej shfaqet interesimi për këtë aktivitet.